

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E Kryeministrit - Ured Premijera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Sistemi Org. Organizim Org. Unit	02.5	Nr. Prot. Broj, Prot. Prot. No.	042133
Nr. faqes Br. strana No. pages	1	Data: Datum: Date	06/06/2018
Proshtrime: 1 a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General

Datë: 06.06.2018

Ref:106/2018

Për: z. Burim Rreci, Sekretar i Përgjithshëm - MTI
CC: z. Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore - ZKM
z. Rexhep Bllaca, Drejtor i Departamentit Ligjor në MTI

Tema: Përgjigje në kërkesën për shkurtrimin e afatit për konsultime publike për Projekt rregulloren për pajisje elektrike dhe Udhëzimit Administrativ për mënyrën e emërimit të trupave për vlerësimin e konformitetit.

I nderuar z. Rreci,

Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit ka pranuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, kërkesën për shkurtrimin e afatit për konsultime publike për Projekt rregulloren për pajisje elektrike dhe Udhëzimin Administrativ për mënyrën e emërimit të trupave për vlerësimin e konformitetit. Pas shqyrtimit të kërkesës si dhe arsytimit për shkurtrim të afatit për konsultime publike të pranuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë si organ propozues, duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Qeverisë 09/2011 të Republikës së Kosovës përkatësisht në nenin 7 paragrafi (6) me të cilin përcaktohet që afati i përcaktuar sipas Rregullosës së Punës së Qeverisë 09/2011 të Republikës së Kosovës prej 15 ditë pune mund të jetë më i shkurtër vetëm në raste urgjente, të cilat propozuesi nuk ka mundur t'i parashihet. Ju njoftojmë që shkurtrimi i afatit të konsultimit publik për Projekt rregulloren për pajisje elektrike dhe Udhëzimin Administrativ për mënyrën e emërimit të trupave për vlerësimin e konformitetit, mund të ndikoj në Marrëveshjen e financimit IPA II, Kushtet e veçanta të programeve vjetore v 2.1. ku në indikatorin 2 përcaktohet: " Duke sjellë në konsultim publik për të paktën 15 ditë pune (apo 3 javë) përmes platformës on-line (shih faqe 27 të kësaj Marrëveshje).

Më respekt,
Fitim Krasniqi,
Sekretar i Përgjithshëm